

NJOFTIM

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit _____)

Per ndryshimin e rendit te ditës te mbledhjes se Asamblesë se Aksionareve date 29 Qershor 2023, sipas kërkesës se paraqitur nga Drejtoria ne përputhje me Nenin 139 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare». Pas kësaj kërkesë, rendi i ditës se mbledhjes date 29 Qershor 2023 behet si me poshtë:

1. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të "Bankës Credins" sha per vitin 2022 sipas IFRS.
2. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të "Bankës Credins" sha per vitin 2022 sipas kërkesave te Bankes se Shqipërisë.
3. Mbi miratimin e Rezultatit Financiar te "Banka Credins" sipas IFRS dhe Bankës se Shqipërisë sh.a per vitin 2022.
4. Mbi miratimin e përdorimit te fitimit të "Bankës Credins" sha per vitin 2022.
5. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me deklarimin e dividendit nga fitimet e vitit 2021.
6. Propozim për miratimin e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, znj. Vera Fazlli LALA, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksioner të shoqërisë "CREDINS BANK" SH.A. nëpërmjet kalimit te fitimit te vitit 2022.
7. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me aksionet ende të panëshkruara të emetuara me Vendimin nr. 04/3, datë 01.10.2019 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a.
8. Propozim per rritjen e kapitalit te Bankes Credins ne masën 15 milion Euro nëpërmjet emetimit te aksioneve te reja.
9. Mbi miratimin e dhënies se bonusit per Drejtorinë ne masën 1% dhe per Keshillin Drejtues ne masen 0.5% te rezultatit financiar te vitit ushtrimor sipas BoA.
10. Propozim per rimerimin e shoqërisë "Grant Thornton Albania" si ekspert kontabël i autorizuar per auditimin e pasqyrave financiare per vitin 2023.
11. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, me rend dite sa me poshtë:
 1. Te jap miratim per lidhjen dhe nenshkrimin e kontrates se siper marrjes dhe bashkepunimit ne ndertim midis shoqerise "SEA LAND ALTERNATIVE INVESTMENT FUND - SHOQËRI KOMANDITE SIK" (referuar si Sea land) dhe shoqerise NATURA RESORT shpk. per pasurite e paluajtshme ne pronesine e Shoqerise (SEA LAND), me objekt zhvillimin dhe ndertimin e pasurive ne pronesi te shoqerise:
 - Nje siperfaqe toke prej 62.200 (gjashtedhete e dy mije e dyqind) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke prej 35.520

(tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e njezet) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;

- Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 50.000 (pesedhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 50.000 (pesedhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
- Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 742.280 (shtateqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 300.000 (treqind mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
- Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 280.000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 190.000 (njqind e nentëdhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
- Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 30.000 (tridhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 20.000 (njezet mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
- Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 10.000 (dhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
- Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 5.000 (pese mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
- Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 5.000 (pese mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028

Në kembim të përfitimit të 30% (tridhjetë perqind) te siperfaqes se ndertimit e perbere nga godina banimi, rekreacioni, utilitete, godina biznesi dhe siperfaqe te perbashket, ne perputhje me koeficientin e pronesise dhe te pjesemarrjes se Pasurisë ne sheshin e ndertimit për të gjithë Zonën Zhvillimore, sipas kushteve dhe termave te percaktuara ne kontraten e siper marrjes.

2. Autorizohet administratori i Shoqerise SEA LAND te nenshkruaje kontraten e siper marrjes dhe te caktoje te gjithë kushtet dhe afatet e mbetura te saj.
 3. Japim miratimin per shprehjen e vullnetit dhe nenshkrimin e vendimit të Asamblese së shoqerise "SEA LAND ALTERNATIVE INVESTMENT FUND - SHOQËRI KOMANDITE SIK" nga ana e Drejtoriti Pergjithshem dhe perfaqesuesit të Banka Credins sh.a., z. Maltin Korkuti.
12. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, me rend dite sa me poshtë:
1. Te jap miratim per lidhjen dhe nenshkrimin e kontrates se siper marrjes dhe bashkepunimit ne ndertim midis shoqerise GREEN VIEW ALTERNATIVE INVESTMENT FUND" SHOQERI KOMANDITE SIK (referuar si Green View) dhe shoqerise NATURA RESORT shpk. per pasurite e paluajtshme ne pronesine e Shoqerise (GREEN VIEW), me objekt zhvillimin dhe ndertimin e pasurive ne pronesi te shoqerise:
 - nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 200.000 (dyqind mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
 - nje siperfaqe toke pyll e kullote prej prej 350.000 (treqind pesedhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 227.960 (dyqind e njëzet e shtate mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
 - nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 182.040 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyzet) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028, si dhe Nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 90.000 (nentëdhjetë mijë) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;

- o nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 5.000 (pese mije) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028;
- o nje siperfaqe toke pyll e kullote prej 55.000 (pesedhjete e pese mije) metra katrore, e ndodhur ne Poro, Vlore, ZK 3028,

Në kembim të përfitimit të 30% (tridhjetë përqind) të sipërfaqes së ndërtimit të përbërë nga godina banimi, rekreacioni, utilitete, godina biznesi dhe sipërfaqe të përbashkëta, në përputhje me koeficientin e pronësive dhe të pjesëmarrjes së Pasurisë në sheshin e ndërtimit për të gjithë Zonën Zhvillimore, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes.

2. Autorizohet administratori i Shoqërisë GREEN VIEW të nënshkruajë kontratën e sipërmarrjes dhe të caktojë të gjithë kushtet dhe afatet e mbetura të saj.
3. Japim miratimin për shprehjen e vullnetit dhe nënshkrimin e vendimit të Asamblesë së shoqërisë "GREEN VIEW ALTERNATIVE INVESTMENT FUND" SHOQËRI KOMANDITE SIK nga ana e Drejtorit Përgjithshëm dhe përfaqësuesit të Banka Credins sh.a., z. Maltin Korkuti.

13. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane me 21.06.2023

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.